



PSE SHQIPTARËVE U KUSHTON MË SHUMË NAFTA NË RAJON?!

RAPORT MONITORIMI

Maj 2026



AUTOR
ILIR BRASHA

QENDRESA QYTETARË



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

PËRMBAJTJA

1.HYRJE	4
2.METODOLOGJIA.....	7
3.STRUKTURA E TAKSAVE TË NAFTËS NË RAJONIN E BALLKANIT	8
4.TASAT NË VENDET E BE-SË.....	11
5.IMPORTI I NAFTËS NDËR VITE NË SHQIPËRI, 2000-2025	12
6.ÇMIMET E NAFTËS SIPAS SHTETEVE.....	13
7.BUXHETI I SHTETIT MBËSHTETET TEK TË ARDHURAT E KRIJUARA NGA KARBURANTET	15
8.SHPENZIME PËR KARBURANT NGA INSTITUCIONET BUXHETORE	17
9.PËRQËNDRIMI I KOMPANIVE TË HIDROKARBUREVE NË BUXHETIN E SHTETIT	18
10. GJETJET KRYESORE	20
11. REKOMANDIME	21
12. REFERENCA.....	22
13. ANEKS.....	23



1. HYRJE

Nafta mbetet kryefjala e ekonomisë globale. Është produkti që ndikon drejtpërdrejt në jetën, tregjet dhe stabilitetin ekonomik të pothuajse çdo vendi në botë. Prej vitesh flitet për zëvendësimin e saj me energji të rinovueshme dhe alternativa më të pastra, por edhe në vitin 2026, bota vazhdon të mbetet thellësisht e varur nga nafta.

Çdo zhvillim politik, konflikt apo krizë në vendet eksportuese të naftës reflektohet menjëherë në ekonominë globale, duke ndikuar çmimet, transportin, prodhimin dhe koston e jetesës. Ndërkohë që numri i makinave elektrike dhe hibride rritet çdo ditë, kërkesa për naftë jo vetëm që nuk po bie ndjeshëm, por në shumë raste vazhdon të mbetet e qëndrueshme, madje edhe në rritje. Kjo tregon se, pavarësisht tranzicionit energjetik, nafta vazhdon të jetë ende zemra e ekonomisë moderne.

Në Shqipëri, kërkesa për naftë ka ardhur vazhdimisht në rritje dhe konsumi për pasojë është rritur nga viti në vit. Ndryshimi i ofertës, në rast konfliktesh qoftë në Europë apo në Lindjen e Mesme kanë sjellë, ulje të ofertës së naftës në tregjet botërore dhe për pasojë rritje të çmimit të saj. Më të prekurat janë sidomos vendet të cilat varen tërësisht nga importet, ku bashkë me naftën importojnë dhe çmimin e rritur të saj.

Rritja e çmimit të naftës reflektohet pothuajse menjëherë në ekonominë e të gjitha vendeve të botës, ndërsa ulja e saj, jo rrallëherë, vonon të japë efektin e njëjtë. Për fat të keq, ndikimi i rritjes së çmimit të naftës nuk kufizohet vetëm tek karburanti, por përhapet në të gjithë ekonominë.

Kjo ndodh sepse pjesa më e madhe e transportit global – nga mallrat ushqimore, te produktet industriale dhe shërbimet, vazhdon të funksionojë kryesisht me naftë. Si pasojë, çdo rritje e çmimit të saj sjell automatikisht rritje të kostove të transportit, të cilat më pas transferohen tek çmimi i produkteve dhe shërbimeve të tjera.

Në këtë mënyrë, rritja e çmimit të naftës shndërrohet në një zinxhir efektsh ekonomike, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e inflacionit dhe në shtimin e kostos së jetesës për qytetarët në mbarë botën.

Në shumë raste, çmimi bazë i naftës importohet nga jashtë, ndërsa çmimi fundor, pra çmimi me të cilin qytetarët e një vendi e blejnë atë nuk është i njëjtë në të gjitha vendet. Kjo vjen kryesisht për shkak të nivelit të ndryshëm



të taksave dhe tatimeve në vende të ndryshme. Pikërisht kjo është arsyeja pse në këtë raport, kemi sjellë strukturën e taksave dhe tatimeve mbi produktin e naftës për Shqipërinë dhe rajonin, si dhe strukturën e akcizës dhe TVSH për Shqipërinë dhe vendet e Bashkimit Europian.

Shqipëria është ndër vendet e rajonit që ka nivelin më të lartë të taksave dhe tatimeve mbi naftën. Niveli i totalit të taksave dhe tatimeve ndryshon në varësi të çmimit final dhe kjo vjen kryesisht nga TVSH-ja e cila është në përqindje mbi vlerën totale të shitjes. Për këtë arsye të gjitha të dhënat për çmimin e naftës janë marrë ato të datës 27 prill 2026. Periudhë kjo që përfshin rritjen e çmimit dhe marrjen edhe të disa masave lehtësuese nga disa shtete.

Rritja e çmimit erdhi si pasojë e luftës që po zhvillohet gjatë kësaj periudhe në Iran. Shqipëria rezulton që të ketë nivelin më të lartë të taksave me përkatësisht 0.73 euro pa përfshirë këtu edhe 20% TVSH mbi çmimin total. Në këtë mënyrë pesha e taksave dhe tatimeve duke llogaritur edhe TVSH shkon në 52.4% të çmimit total final. Pra, më shumë se gjysma e çmimit që paguan një qytetar shqiptar shkon pikërisht në buxhetin e shtetit. Kështu, Shqipëria shënon nivelin më të lartë të barrës së taksave dhe tatimeve në një litër naftë krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Vendi i dytë me barrën më të lartë të taksave dhe tatimeve në një litër naftë është Greqia me 45.8%, ndjekur nga Kroacia me 45.7%, nga Serbia me 45.2%, nga Kosova me 39.7%, nga Bosnje & Hercegovina me 37%, Mali i Zi me 34.1% dhe në fund Maqedonia e Veriut me 26.6%. Duhet pasur në venmendje që Mali i Zi ka përgjysmuar akcizën si masë lehtësuese për qytetarët nga 0.44 euro në 0.22 euro, kurse Maqedonia e Veriut ka ulur TVSH nga 18% në 10%, prandaj e pesha e taksave në këtë datë të caktuar është aq e ulët. Gjithsesi edhe me normat normale, pra jolehtësuese të dyja këto vende do mbanin nivelin më të ulët të taksave dhe tatimeve krahasuar me Shqipërinë.

Shqipëria ka nivelin më të lartë të barrës fiskale në një litër naftë sepse qytetarët shqiptarë përveç akcizës që është 39.4 lekë për litër, paguajnë edhe 27 lekë për litër si taksë qarkullimi, 3 lekë për litër si taksë karboni si dhe në fund edhe TVSH 20% mbi vlerën totale. Ajo që bën diferencën më të madhe është pikërisht taksa e qarkullimit, e cila e bën Shqipërinë si vendin me çmimin më të lartë të naftës në rajon dhe jo vetëm. Në datën 27 prill 2026, bazuar në të dhënat e çmimit të naftës nga Global Petrol Prices, rezulton që Shqipëria është ndër vendet me çmimin më të lartë të naftës në botë. Përkatësisht, Shqipëria është vendi i 9-të me çmimin më të lartë në botë. Në



Europë, Shqipëria renditet si vendi i pestë me çmimin më të lartë të naftës, duke u renditur vetëm pas shteteve si Finlanda, Holanda, Zvicra dhe Danimarka. Edhe pse çmimi i naftës është ndër më të shtrenjtit në botë, Shqipëria e ka rritur konsumin e naftës ndër vite duke e 2.2 fishuar sasinë e importeve në 25 vite. Në vitin 2025, importet e naftës kanë arritur në 7,409 mijë tonë karburant, ose rreth 707 litra për një mjet në Shqipëri.

Përsa i takon normës së akcizës dhe TVSH-së Shqipëria renditet në mes të vendeve të Europës, por ajo që bën diferencën përsëri është taksa e qarkullimit e cila shton barrën e qytetarëve shqiptarë në pagesën fundore të një litri naftë.

Buxheti i Shqipërisë nga ana tjetër duket se është përfituesi kryesor i barrës së lartë fiskale mbi naftën. Qytetarët paguajnë, buxheti i shtetit mbahet nga këto taksa. Përkatësisht në një përlogaritje të detajuar të vlerës totale fundore të krijuar si shkak i pagesës së taksave dhe tatimeve nga qytetarët shqiptarë mbi naftën rezulton që për vitin 2025, shqiptarët kanë paguar 73.6 miliard lekë ose sa 9.76% e totalit të të ardhurave të krijuara nga buxheti i shtetit. Nga kjo duket qartë se buxheti i shteti ka një varësi të lartë nga taksat dhe tatimet e vendosura mbi naftën.

Për këtë arsye, dhe për shkak të politikave të gjelbra që po zbatohen në mbarë botën, përfshirë edhe Shqipërinë, si dhe rritjes së shpejtë të përdorimit të mjeteve elektrike, Shqipëria duhet të nisë gradualisht uljen e varësisë së buxhetit të shtetit nga të ardhurat që vijnë nga nafta.

Në vitet e ardhshme, me uljen e përdorimit të karburanteve fosile, të ardhurat nga taksat mbi naftën mund të bien ndjeshëm, duke krijuar vështirësi për financat publike nëse ekonomia mbetet e varur nga ky burim. Për këtë arsye, nevojiten politika të reja që diversifikojnë burimet e të ardhurave të shtetit dhe mbështesin tranzicionin energjetik.

Nga ana tjetër, barra e lartë fiskale mbi naftën mund të shërbejë edhe si një nxitje për qytetarët shqiptarë që të orientohen më shumë drejt mjeteve ekologjike, elektrike apo hibride, të cilat kanë kosto më të ulët përdorimi dhe ndikim më të vogël në mjedis.

Jo vetëm qytetarët blejnë dhe konsumojnë naftë por edhe institucionet buxhetore. Për të kuptuar mbi shpenzimet e thesarit të shtetit në naftë, janë



analizuar të gjitha transaksionet e thesarit përgjatë periudhës 2022-2025 për "karburant dhe vaj". Rezulton që në vitin 2025, institucionet shtetërore kanë shpenzuar plot 3.63 miliard lekë për karburant dhe vaj. Kjo shifër mund të përkthehen në mbi 18 mijë tonë naftë të konsumuar nga institucionet shtetërore. Kompanitë kryesore që përfitojnë nga buxheti i shtetit janë Kastrati dhe Gega Oil, përkatësisht Kastrati ka përfituar rreth 55.3% të total shpenzimeve shtetërore që janë kryer për karburant dhe vaj, kurse Gega Oil nga ana tjetër ka përfituar rreth 6.9% të totalit të shpenzimeve përgjatë periudhës 2022-2025. Edhe pse të ardhurat e krijuara nga nafta janë të larta duket se kompanitë e hidrokarburave fitojnë shumë pak nga shitja e këtyre produkteve të paktën nga ato që raportojnë në QKB. Rezulton që marzhi i fitimit të Kastratit për vitin 2024 ka qenë vetëm 1.9%, ndërkohë që për Gega Oil vetëm 0.3%.

Si përfundim e gjithë analiza është ndërtuar për të pasur një panoramë të plotë të strukturës së çmimit të hidrokarbureve në rajon dhe më gjërë, peshës së të ardhurave të krijuara nga nafta në buxhetin e shtetit si dhe analiza e shpenzimeve të insticioneve shtetërore për këtë produkt.

2. METODOLOGJIA

Ky raport është ndërtuar për të sjellë një qasje të përgjithshme dhe të detajuar për strukturën e taksave mbi naftën në Shqipëri dhe vendet e tjera të rajonit, si dhe strukturën e akcizës si taksë kryesore mbi naftën në të gjitha vendet e Bashkimit Europian. Të dhënat janë marrë nga burime zyrtare, duke sjellë të dhëna koherente dhe të sakta për secilën nga taksat mbi naftën. Ministritë përkatëse të secilit nga vendet publikojnë normën e taksave mbi naftën dhe aty është fokusuar edhe ky raport. Po ashtu akciza për vendet e rajonit është tërhequr nga të dhënat e Tax Foundation Europe, një organizatë që sjell të dhëna në kohë reale për taksat në Bashkimin Europian e më gjërë.

Në mënyrë që të kemi një qasje më të gjërë të tematikës, në raport janë sjellë të dhëna edhe të importit të naftës në Shqipëri, këto të marra nga Ministria e Financës, në raportet e saj analitike mujore.

Gjithashtu për të sjellë edhe një qasje se sa para paguajnë shqiptarët në naftë, është bërë një përlogaritje bazuar në sasinë e importuar dhe nivelin e taksave. Kalkulimet kanë bërë të mundur që të shikojmë edhe peshën e lartë që të ardhurat nga taksat mbi naftën kanë në total të ardhurat e buxhetit të shtetit. Të gjitha të dhënat janë marrë nga Ministria e Financave.



Jo vetëm qytetarët blejnë naftë, por edhe Institucionet Buxhetore. Për këtë janë analizuar në mënyrë të detajuar të gjitha transaksionet e thesarit nga viti 2022 deri në vitin 2025, në kategorinë e shpenzimeve “Karburant dhe vaj”. Të dhënat janë marrë si databaza ditore nga Ministria e financës dhe janë përpunuar për qëllim të këtij raporti. Analiza e detajuar e tyre ka sjellë totalin e shpenzimeve të buxhetit të shtetit të kryer për karburant dhe vaj, si dhe renditjen e përfituesve kryesorë, pra kompanitë kryesore të cilat kanë shitur këto produkte në institucionet shqiptare.

3. STRUKTURA E TAKSAVE TË NAFTËS NË RAJONIN E BALLKANIT

Nafta është një nga produktet hidrokarbure më të rëndësishme dhe më të përdorura në botë, ndërsa çmimi i saj ndryshon nga një shtet në tjetrin në varësi të taksave, tregut dhe kostove të furnizimit. Si një burim kryesor energjie për transportin dhe ekonominë, çmimi i naftës ndikon drejtpërdrejt në koston e lëvizjes së mallrave dhe shërbimeve. Për këtë arsye, çdo rritje e çmimit të karburantit reflektohet zinxhir edhe te produktet e tjera të konsumit, duke rritur kostot e transportit, prodhimit dhe çmimet për qytetarët. Në të kundërt, ulja e çmimit të naftës krijon mundësi për lehtësim të kostove ekonomike dhe stabilizim të çmimeve në treg.

Në përgjithësi, të gjitha shtetet kanë çmime të ndryshme të naftës dhe kjo ndodh për një sërë arsesh. Vendet që importojnë naftën importojnë njëkohësisht edhe çmimin e saj, pasi nuk kanë mundësi ta përcaktojnë vetë atë në tregun ndërkombëtar. Për këtë arsye, çmimi final i naftës në këto vende ndryshon kryesisht për shkak të strukturës së taksave, kostove të transportit dhe marzhit të fitimit që përcaktojnë kompanitë e shitjes së karburanteve.

Për të pasur një pasqyrim të qartë të strukturës së taksave mbi naftën në këtë raport është sjellë struktura e taksave për vendet e Ballkanit në monedhën lokale dhe totali i tyre pa përfshië TVSH në euro. TVSH ndryshon dhe është në të gjitha vendet mbi totalin e çmimit të naftës, që nënkupton është edhe mbi taksat e tjera.

Nga struktura e taksave, duket qartë që barra më e madhe e taksave mbi naftën mbahet nga shqiptarët e Shqipërisë. Së pari në Shqipëri është akciza në vlerën e 39.4 lekëve (0.41 euro), ndërkohë që janë shtesë edhe taksat e qarkullimit në vlerën 27 lekë (0.28 euro) për litër dhe taksat e karbonit në vlerën



3 lekë (0.03 euro) për litër. Në total taksat në euro pa përfshirë TVSH që është mbi çmimin total bashkë me taksa shkon në 0.73 euro.

Taksën e dytë më të lartë ndër vendet e Ballkanit të marra në shqyrtim i ka Serbia që ka një akcizë 55.53 RSD ose 0.47 euro. Po ashtu Mali i Zi ka një akcizë të barabartë me 0.44 euro, Greqia dhe Kroacia akcizë të barabartë me 0.41 euro. Nga ana tjetër vetëm Bosnje dhe Hercegovina ka edhe taksa shtesë në rajon përpos Shqipërisë. Bosnja dhe Hercegovina ka një akcizë të barabartë me 0.3 BAM (0.15 euro), dhe 0.4 BAM (0.2 euro) taksa të tjera që përfshijnë ato për përkujdesjen e rrugëve dhe autostradave. Taksat totale pa TVSH të këmbjera në euro arrijnë në 0.36 euro, shumë më pak sesa Shqipëria që totali shkon në 0.73 euro. Kosova ka një akcizë të barabartë me 0.36 euro, ndërkohë që Maqedonia ka nivelin më të ulët të akcizës prej vetëm 0.25 euro.

Struktura e taksave mbi naftën tregon qartë që Shqipëria mbart nivelin më të lartë të taksave në rajon mbi naftën dhe kjo vjen pikërisht si shkak i taksës së qarkullimit që i shtohet asaj të akcizës dhe taksës së karbonit.

Nga ana tjetër TVSH më të lartë mbi naftën e ka Kroacia me 25% të total vlerës së çmimit final, ndjekur nga Greqia me 24% dhe Mali i Zi 21%. Shqipëria dhe Serbia kanë një nivel të TVSH të barabartë me 20%. Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë TVSH të barabartë me 18%. TVSH-në më të ulët në vendet e rajonit të marra në shqyrtim e ka Bosnje dhe Hercegovina me 17%.

Tabela 1: Struktura e taksave mbi naftën në vendet e rajonit të Ballkanit, në monedhën lokale dhe Euro

Vendi	Akciza	Taksa e Qarkullimit	Taksa e Karbonit	Kursi i këmbimit	TTL pa TVSH Taksa (Euro)	TVSH
Shqipëria (Lekë)	39.4	27	3	0.0105	0.73	20%
Kosova (Euro)	0.36			1.0000	0.36	18%
Maqedonia e Veriut (MKD)	15.121			0.0162	0.25	18%
Serbia (RSD)	55.53			0.0085	0.47	20%
Greqia (Euro)	0.41			1.0000	0.41	24%
Bosnje & Hercegovina (BAM)	0.30	0.40		0.5113	0.36	17%
Mali i Zi (Euro)	0.44			1.0000	0.44	21%
Kroacia (Euro)	0.41			1.0000	0.41	25%

Burimi: Sisteme fiskale, Përpunim i autorit

Për të shikuar më qartë se sa është pesha e taksave mbi naftën në vendet e Ballkanit është bërë struktura e plotë e çmimit të naftës në datën 27 prill 2026.




Çmimet finale mesatare janë marrë nga Global Petrol Prices dhe për Kosovën është marrë bazuar në vendimet që përcaktojnë çmimin maksimal të lejuar.

Nga analiza totale e peshës që mbajnë taksat mbi çmimin final të naftës, rezulton që barrën më të lartë të taksave mbi naftën e mbajnë pikërisht qytetarët shqiptarë. Përkatësisht 52.4% e çmimit final është taksa dhe vetëm 47.6% përfshin çmimin e blerjes, kostot dhe marzhin e vetë kompanisë. Barrën më të lartë, pas Shqipërisë në taksa mbi naftën e mban Greqia, me përkatësisht 45.8% e totalit të çmimit. Po ashtu edhe kroatët paguajnë 45.7% të totalit të çmimit të naftës si taksa për shtetin.

Barrën më të ulët të taksave mbi naftën e mbajnë qytetarët e Maqedonisë së Veriut, që paguajnë vetëm 26.6% të çmimit si taksa mbi naftën. Duhet pasur parasysh se në 27 prill, qeveria Maqedonase kishte ulur nivelin e TVSH nga 18% në 10%, prandaj edhe barra e taksave është ulur në ato momente. Po njësoj barrën e dytë më të ulët për naftën e kanë qytetarët e Malit të Zi që paguajnë vetëm 34.1% të totalit të çmimit. Edhe në rastin e Malit të Zi, akciza është përgjysmuar nga 0.44 euro në 0.22 euro. Prandaj edhe barra shkon në nivelin 34.1%.

Grafiku 1: Pjesa e çmimit fundor të naftës që shkon për taksa, 27 prill 2026.



Burimi: Përpunim i autorit

Në këtë tabelë është dhënë e detajuar struktura e taksave për vendet e Ballkanit që përfshinë taksat dhe nivelin e TVSH-së mbi naftën. Të gjitha çmimet janë konvertuar në lekë.



Tabela. 2: Struktura e taksave mbi naftën për vendet e Ballkanit. Taksat e detajuara në datën 27 prill, në lekë

Vendi	Çmimi për Litër	Kursi i këmbimit	Akciza	Taksa e Qarkullimit	Taksa e Karbonit	TVSH	TTL Taksa	Çmimi pa taksa	% TTL Taksa /Çmim	TVSH %
Maqedonia e Veriut	141.82	1.56	23.59	-	-	14.18	37.77	104.05	26.6%	10.0% ¹
Kosova	158.58	95.53	34.39	-	-	28.54	62.94	95.64	39.7%	18.0%
Mali i Zi	160.48	95.53	21.02 ²	-	-	33.70	54.72	105.76	34.1%	21.0%
Bosnia & Hercegovina	170.76	48.80	14.64	19.52	-	29.03	63.19	107.57	37.0%	17.0%
Serbia	178.18	0.81	44.98	-	-	35.64	80.62	97.57	45.2%	20.0%
Greqi	179.49	95.53	39.17	-	-	43.08	82.24	97.24	45.8%	24.0%
Kroacia	187.61	95.53	38.80	-	-	46.90	85.70	101.91	45.7%	25.0%
Shqipëria	214.00	1.00	39.40	27.00	3.00	42.80	112.20	101.80	52.4%	20.0%

Burimi: Përpunim i autorit

4. TASAT NË VENDET E BE-SË

Në këtë raport janë analizuar edhe niveli i akcizës dhe TVSH-së për vendet e BE-së, si dy taksat që ndikojnë më shumë në taksat totale mbi naftën.

Çmimet për të gjetur vlerën e TVSH-së janë marrë ato të datës 27 prill 2026. Rezulton që duke marrë në konsideratë vetëm akcizën dhe TVSH-në, taksat më të larta në një litër naftë i ka Danimarka, përkatësisht 1.17 euro/litër, ndjekur nga Irlanda me 1.11 euro/litër dhe Italia me 1.09 euro/litër. Në këtë renditje Shqipëria gjendet e 18-ta nga vendet pjesë e BE-së. Nga vendet e BE-së tre vendet me nivelin më të ulët të akcizës dhe TVSH-së mbi naftën janë Malta me vetëm 0.55 euro për litër, Bullgaria me 0.68 euro për litër dhe Spanja me 0.74 euro për litër. Më poshtë se Shqipëria nivelin e akcizës dhe TVSH-së bashkë e kanë edhe vende të tjera pjesë të BE-së si Qipro, Polonia, Sllovakia, Republika Çeke, Austria, Luksemburgu, Hungaria dhe Estonia. Të gjitha këto vende kanë barrë më të ulët sesa Shqipëria në një litër naftë përse i takon akcizës dhe TVSH-së.

¹ Maqedonia e Veriut ka reduktura TVSH nga 18% në 10%.

² Mali i Zi ka përgjysmuar akcizën nga 0.44 në 0.22 euro.



Tabela 3: BE-Shqipëri krahasim i Akcizës dhe TVSH mbi naftën, në euro, 27 prill 2026

Shteti	TTL Akciza + TVSH	Akciza Euro/Litër	TVSH Vlerë	TVSH %
Danimarka	1.17	0.57	0.61	25.0%
Irlanda	1.11	0.62	0.50	23.0%
Italia	1.09	0.63	0.45	22.0%
Finlanda	1.07	0.49	0.59	26.0%
Mbretëria e Bashkuar	1.05	0.61	0.44	20.0%
Belgjika	1.04	0.60	0.44	21.0%
Holanda	1.04	0.55	0.48	21.0%
Franca	1.03	0.59	0.43	20.0%
Portugalia	0.99	0.54	0.45	23.0%
Lituania	0.98	0.55	0.43	21.0%
Slovenia	0.93	0.55	0.38	22.0%
Rumania	0.90	0.55	0.35	19.0%
Kroacia	0.90	0.41	0.49	25.0%
Gjermania	0.89	0.47	0.42	19.0%
Suedia	0.88	0.36	0.52	25.0%
Letonia	0.87	0.47	0.40	21.0%
Greqia	0.86	0.41	0.45	24.0%
Shqipëria	0.86	0.41	0.45	20.0%
Estonia	0.84	0.43	0.41	22.0%
Hungaria	0.84	0.38	0.46	27.0%
Luksemburgu	0.78	0.47	0.32	17.0%
Austria	0.78	0.40	0.38	20.0%
Republika Çeke	0.78	0.41	0.37	21.0%
Slovakia	0.78	0.37	0.41	23.0%
Polonia	0.77	0.39	0.37	23.0%
Qipro	0.76	0.40	0.36	19.0%
Spanja	0.74	0.38	0.36	21.0%
Bullgaria	0.68	0.33	0.35	20.0%
Malta	0.55	0.33	0.22	18.0%

Burimi: Tax Foundation Europe, përpunuar nga autori

5. IMPORTI I NAFTËS NDËR VITE NË SHQIPËRI, 2000-2025


Importi i karburantit ka shënuar rritje të lartë përgjatë viteve, duke arritur kulmin në vitin e fundit të marrë në konsideratë, 2025. Në vitin 2025, importet e naftës kanë arritur në 7,409 mijë tonë karburant. Për 25 vite, importi i karburanteve është 2.2 fishuar. Rritja e vazhdueshme e importimit të naftës ka ardhur si pasojë e shtimit të mjeteve në qarkullim. Ajo që vërehet, sidomos në dy vitet e fundit është shtimi i importit të mjeteve elektrike që mund të ndryshojë situatën dhe kërkesën e mëtejshme për produktin e naftës. Në vitet e hershme të këtij grafiku, importi i karburantit ka qenë më i ulët edhe për shkak të funksionimit të rafinerive të naftës në vend. Sot që po shkruhet ky



raport, e gjithë nafta e nxjerrë nga nëntoka shqiptare eksportohet vetëm si lëndë e papërpunuar duke mos sjellë asnjë vlerë të shtuar në ekonomi. Kuptohet që risku i ndërtimit të rafinerive, gjatë periudhës së tanishme do të kishte kosto për shkak të kalimit tek mjetet alternative dhe jo me konsum të naftës, por gjithsesi vlera e shtuar në ekonomi, të paktën edhe për 25 vitet e ardhshme që mendohet që do të qëndrojë nafta në treg, do të sillnin plotësimin e nevojave për naftë të shqiptarëve dhe rritje të prodhimit përfundimtar të naftës në vend.

Nga grafiku mund të shikohet qartë se në vitin 2010 importi i naftës ishte rreth 4,844 mijë tonë, ndërkohë që pas 15 vitesh ka arritur në rreth 7,409 mijë tonë.

Grafik. 2 Karburant i importuar ndër vite, 2000-2025, në mijë tonë



Burimi: Ministria e Financave, përpunim i autorit

6. ÇMIMET E NAFTËS SIPAS SHTETEVE

Shqipëria ka një ndër çmimet më të larta të naftës në botë. Janë një sërë portalesh online, të cilat monitorojnë çmimet në kohë reale (jo çdo ditë) të naftës në vende të ndryshme të botës, për të shikuar edhe diferencat në çmim dhe lëvizjet e çmimit në kohë.

Dy nga portalet më të përdorura janë Trading Economics dhe Global Petrol Prices. Trading Economics shfaq çmimet e naftës për 95 vende të botës, ndërkohë që Global Petrol Prices shfaq të dhëna për 169 vende të botës. Për këtë arsye të dhënat janë marrë nga Global Petrol Prices, për të pasur një pasqyrim sa më të gjërë të situatës. Të gjitha çmimet janë marrë në lekë, për




të bërë krahasimin midis vendeve. Çmimet janë mesatare që shiten tek konsumatori fundor.

Shqipëria rezulton ndër vendet me çmimin më të lartë të naftës në botë, duke u renditur si vendi i 9-të me çmimin më të lartë të naftës në botë. Çmim më të lartë të naftës sesa Shqipëria e kanë vetëm Finlanda, Izraeli, Holanda, Zvicra, Danimarka, Singapori, Malavia dhe Hong Kongu. Pra në Europë vetëm Finlanda, Holanda, Zvicra dhe Danimarka kanë çmim të naftës më të lartë sesa ai në Shqipëri. Tabela për të shikuar listën e çmimeve të naftës në të gjitha vendet e botës është në seksionin e aneksit (Tabela 5).

Duke marrë në shqyrtim vendet e Ballanit, përjashtuar Kosovën, pasi nuk kishte të dhëna, Shqipëria ka çmimin më të lartë të naftës në gadishull. Çmimin më të lirë në datën 27.04.2026 e mban Maqedonia e Veriut me vetëm 141.82 lekë, ndjekur nga Mali i Zi me 160.48 lekë. Shqipëria kryeson me çmimin më të lartë me 214 lekë për litër dhe afër saj është vetëm Kroacia me 187.61 lekë ose 26.4 lekë për litër më pak. Në renditje vazhdon Greqia me 179.49 lekë për litër ose 34.51 lekë për litër më lirë se Shqipëria. Diferenca në çmim midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut që ka çmimin më të lirë është 72.18 lekë. Pra qytetarët shqiptarë paguajnë rreth 70 lekë më shumë në një litër naftë sesa qytetarët maqedonas.

Grafik 3: Çmimet e naftës në Lekë/Litër në vendet e Ballkanit, në datën 27.04.2026



Burimi: Global Petrol Prices,

https://www.globalpetrolprices.com/diesel_prices/



7. BUXHETI I SHTETIT MBËSHTETET TEK TË ARDHURAT E KRIJUARA NGA KARBURANTET

Të ardhurat e krijuara nga taksat e tatimet që vendosen mbi karburantin sjellin një pjesë të rëndësishme të totalit të të ardhurave që krijohen nga Buxheti i Shtetit. Për të analizuar varësinë që ka Buxheti i Shtetit nga të ardhurat që krijohen pikërisht nga taksat dhe tatimet e naftës janë marrë në shqyrtim të ardhurat e krijuara në vitin 2024 dhe vitin 2025. Në vitin 2024, të ardhurat totale janë marrë nga Buxheti faktik i miratuar në Kuvendin e Shqipërisë, ndërkohë që të dhënat për totalin e të ardhurave të krijuara në vitin 2025 janë marrë nga Treguesit Fiskal të publikuar nga Ministria e Financave (pra të dhëna paraprake). Në konsideratë janë marrë të ardhurat e sjella nga akciza, taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe tatimi mbi vlerën e shtuar. Çmimi mesatar i shitjes së naftës përgjatë gjithë periudhës është supozuar rreth 180 lekë, që nënkupton që TVSH është e barabartë me rreth 30 lekë.

Në total Buxheti i shtetit në vitin 2024 ka mbledhur të ardhura prej 657,563 milionë lekë, ndërkohë që të të ardhurat e grumbulluara vetëm nga taksat dhe tatimet mbi naftën vetëm sipas vlerësimeve në këtë raport arrijnë në 65,362 milionë lekë, ose sa 9.2% e total të ardhurave të grumbulluara nga Buxheti i Shtetit. Specifikisht rreth 25,908 milionë lekë u mbledhën nga akciza, 19,727 milionë lekë nga TVSH, 17,754 milionë lekë nga Taksa e Qarkullimit dhe 1,973 milionë lekë nga Taksa e karbonit. Thënë kjo, vetëm të ardhurat e grumbulluara nga nafta, përbëjnë pothuajse një të dhjetëtn e total të ardhurave të grumbulluara nga arka e shtetit, duke krijuar një varësi të lartë pikërisht nga produkti i naftës.

Tabela 4: Përlllogaritje e taksave të grumbulluara nga nafta në Shqipëri në vitet 2024-2025, në million lekë.

	Treguesi	2024	2025
	Sasia e Karburantit në tonë	657,563	740,863
Taksa/Tatime Karburant	Akciza - Lekë/Litër	39.4	39.4
	Taksa e Qarkullimit - Lekë/Litër	27	27
	Taksa e Karbonit - Lekë/Litër	3	3
	TVSH - Lekë/Litër	30	30



Vlera e të ardhurave në Buxhet nga Karburanti	Akciza në mln lekë	25,908	29,190
	Taksa e Qarkullimit në mln lekë	17,754	20,003
	Taksa e Karbonit në mln lekë	1,973	2,223
	TVSH në mln lekë	19,727	22,226
	Total Karburanti në mln lekë	65,362	73,642
	Total të Ardhura në mln lekë	710,587	754,608
% e të ardhurave nga Karburanti ndaj Total Buxheti i Shtetit	Akciza (% ndaj TTL të ardhura)	3.65%	3.87%
	Taksa e Qarkullimit (% ndaj TTL të ardhura)	2.50%	2.65%
	Taksa e Karbonit (% ndaj TTL të ardhura)	0.28%	0.29%
	TVSH (% ndaj TTL të ardhura)	2.78%	2.95%
	Total Karburanti (% ndaj TTL të ardhura)	9.20%	9.76%

Burimi: Ministria e Financave, përpunim i autorit

Në vitin 2025, varësia e buxhetit të shtetit nga nafta është edhe më e lartë, duke arritur në rreth 9.76% me një rritje prej afërsisht 0.56 pikë përqindje nga viti i kaluar. Të ardhurat e vlerësuara nga nafta që shkojnë në buxhetin e shtetit për vitin 2025 kanë arritur në 73,642 milionë lekë, ndërkohë që të ardhurat totale të buxhetit të shtetit kanë qenë 740,863 milionë lekë. Të ardhurat nga nafta të ndara sipas burimit, 29,190 milionë lekë kanë ardhur nga akciza, 22,226 milionë lekë nga TVSH-ja, 20,003 milionë lekë nga taksa e qarkullimit dhe 2,223 milionë lekë nga taksa e karbonit. Në total, duket sikur Buxheti i shtetit ka krijuar një varësi të lartë vetëm nga të ardhurat e krijuara nga nafta. Vetëm nga një produkt importi si nafta buxheti i shtetit arkëton një të dhjetën e total të ardhurave të tij. Në pamje të parë, duket sikur shtetit i intereson përdorimi i mëtejshëm i makinave që punojnë me naftë, por kur mendohet për më gjatë, duhen pasur në mendje agjendat e gjelbërta që promovojnë përdorimin e makinave elektrike, apo makinave të ashtuquajtura ne mbrojtje të mjedisit. Në këtë mënyrë nga njëra anë taksat e shtuara në një litër nafte mund të ndikojnë pozitivisht në heqjen dorë nga



përdorimi të makinave të dëmshme për mjedisin, por nga ana tjetër duhet pasur kujdes sepse të ardhurat e krijuara nga nafta përbëjnë një pjesë relativisht të lartë të të ardhurave totale dhe kalimi tek makinat elektrike do të krijonte një boshllëk të madh në buxhetin e shtetit. Duhet bërë tranzicioni i kujdesshëm i makinave dhe diversifikimit të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit.

Sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë synohet që në vitin 2030, 60% e makinave të shitura duhet të jenë elektike për të arritur objektivin net 0 të CO₂ në vitin 2050.³ Pra, gjatë viteve në vazhdim parashikohet që të ketë një kalim nga makinat me motor me naftë tek ato elektrike. Edhe pse deri më tani tranzicioni ka qenë vertetë i ulët, dhe importimi i naftës ka ardhur në rritje ndër vite, përsëri edhe tregu shqiptar po njih progres në përdorimin e makinave elektrike. Në total nga 80,739 autovetura të regjistruara për herë të parë në vitin 2025, 5,666 prej tyre ishin elektrike, pra rreth 7% e total mjeteve të regjistruara⁴. Në total deri në dhjetor 2025 nga 847'191 autovetura të regjistruara, vetëm 12,089 prej tyre ishin elektrike⁵. Kjo do të thotë që pothuajse gjysma e stokut të makinave elektrike të regjistruara deri në dhjetor 2025, janë regjistruar për herë të parë në vitin 2025, çfarë tregon një trend të lartë rritës të blerjes së këtyre makinave nga shqiptarët. Pra kemi dy kahe, nga njëra anë është rritur konsumi i naftës dhe nga ana tjetër po rritet me normë të lartë edhe blerja e makinave elektrike. Kjo rritje e makinave elektrike duhet parë me kujdes nga qeveria shqiptare për shkak se niveli i lartë i të ardhurave që nafta sjell në buxhet mund të ndikojë negativisht në vitet e para të tranzicionit.

8. SHPENZIME PËR KARBURANT NGA INSTITUCIONET BUXHETORE

Institucionet buxhetore kryejnë shpenzime përpos të tjerave edhe për karburant dhe vaj. Duke analizuar transaksionet e thesarit të shtetit për vitet 2022-2025, duke i përpunuar në kuadër të këtij raporti, rezulton që shpenzimet e karburant dhe vaj për institucionet buxhetore janë të larta. Përkatësisht në

³ <https://www.iea.org/reports/by-2030-evs-represent-more-than-60-of-vehicles-sold-globally-and-require-an-adequate-surge-in-chargers-installed-in-buildings>


⁴ <https://datastudio.google.com/u/0/reporting/8d58f55d-117f-4c4e-939a-2b42188966f4/page/VPWqB>

⁵ <https://datastudio.google.com/u/0/reporting/e5d2e6b7-cd20-47e7-90c4-c273fe11c7bf/page/8cA1B>



vitin 2025 shpenzimet buxhetore për karburant dhe vaj arrijnë në rreth 3.63 miliard lekë. Ndër vitet e marra në shqyrim shpenzimet më të mëdha nga Buxheti i Shtetit për karburant dhe vaj janë bërë në vitin 2024, përkatësisht në vlerën 4.2 miliard lekë. Në vitin 2025 transaksionet e thesarit për karburant dhe vaj kanë qenë më të ulëta se 2022, 2023 dhe 2024. Pra një pjesë e të ardhurave që vijnë nga karburanti shkon përsëri tek kompanitë e karburantit nëpërmjet blerjes së karburantit nga ata.

